



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:232708  
Datë: 15.03.2024  
Numri i dokumentit: 05457801

**C-IV-14-5953**

**Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A-** Prishtinë  
*kundër*

*Ankuesi*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit për NSH “Prizren Coop” Prizren (në likuidim), Rr.**  
“Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 14 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Ankuesi i bartë shpenzimet gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 25 gusht 2014, ankuesi parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ050-0038, të datës 24 korrik 2014, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për fatura të papaguara, në shumë prej 9,946.00 Euro, për borxhin e energjisë elektrike që e ka krijuar N.SH. ”PrizrenCoop” (në likuidim).

Me 12 shkurt 2024, gjykata lëshoj për ankuesin urdhër për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh:

*Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 12 shkurt 2024, Gjykata përmes urdhrit kërkoj nga ankuesi, që të bëjë pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëjë pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të Dhomës së Posaçme në lidhje me udhëzimin e KGJK-së nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Vërejtja ishte pranuar nga ankuesi me datë 16.02.2024, mirëpo ai nuk u përgjigj brenda afatit të caktuar prej 15 ditësh, e as deri me vendosjen e këtij Aktvendimi.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

---

Diellza Hoxha

Gjyqtare